

## **SHPALLJE VETEM PËR NËPUNËS CIVILE, LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË**

**Përgjegjës Sektori, në Sektorin ALBPOS-it, në Drejtorinë e Gjeodezisë  
dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin  
Gjeohapësinor.**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Departamenti i Administratës Publike s shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

- Përgjegjës Sektori, në Sektorin ALBPOS-it, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

**Kategoria e pagës III-a/1**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)**

**aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**LEVIZJE PARALELE:**

**11 Maj 2015**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**NGRITJE NE DETYRE:**

**16 Maj 2015**

## Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- a- Përgatit dhe organizon punën për mirëmbajtjen e infrastrukturës së sistemit ALBPOS(GNSS) me qëllim ofrimin e shërbimit të përdorimit të metodave GPS të pozicionimit global në kohë reale(RTK) dhe mbasprocesimit të matjeve(PP).
- b- Organizon punën e sektorit në zbatim të ligjit 72/2012 dhe akteve të tij, në funksion të mbajtjes në efikasitet të sistemit ALBPOS në lidhje me ruajtjen e të dhënave, saktësinë dhe metodologjinë e llogaritjes së pikave të sistemit.
- c- Ka detyrë të monitorojë, identifikojë dhe të asistojë të gjithë përdoruesit e sistemit ALBPOS nëpërmjet aksesimit të të dhënave të bazës së varesi të teknologjisë së aplikuar në sistemet e marës dhe dhenës.
- d- Ka për detyrë të organizojë punën për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e teknologjisë së aplikuar në sistemin qendror dhe stacionet e bazës të ALBPOS.
- e- Ka për detyrë të koordinojë punën me sektorët e drejtorisë së vartësisë për politikën e investimeve dhe perspektivën e sistemit ALBPOS.(EPN dhe EUREF).
- f- Identifikon nevojat dhe ben propozime për ndryshimet ligjore, rregullore, urdheresa që lidhen me funksionimin e Sistemit ALBPOS dhe rregullojnë marrëdhënjet me përdoruesit e sistemit.

## 1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-a/1 );
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- d- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Gjeodezi. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- e- Të kenë 3 vjet përvojë pune në fushën përkatëse.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen zyrtare elektronike të Departamentit të Administratës Publike, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijimësi udhëzimet online.

<http://recruit.dap.gov.al/Register.aspx>

***Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për levizjen paralele duhet të bëhet brenda datës 11 Maj 2015.***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

---

Në datën 13 Maj 2015, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçmedo të njoftohen individualisht nga Departamenti i Administratës Publike (*nëpërmjet adresës së e-mail*), për shkaqet e moskualifikimit.

**1.4****FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Të njohë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me, infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- b- Të njohë legjislacionin e BE i cili do jete pika e referimit ne hartimin e akteve nënligjore të ASIG;
- c- Të ketë njohuri për legjislacionin e BE-së që lidhet me gjeoinformacionin (Direktiva Inspire);
- d- Të ketë njohuri sistemeve Reference të pozicionimit GNSS ne Shqipëri (ALBPOS);
- e- Të ketë njohuri sistemeve Reference të pozicionimit GNSS Ndërkombëtare.

**1.5****MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**1.6****DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerëimit të kandidatëve, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët

pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga DAP, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2 NGRITJA NË DETYRË

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Departamentit të Administratës Publike, duke filluar nga data 21 Maj 2015.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### 2.1

#### KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- e- Të kenë 3 vjet përvojë pune në kategorinë e pagës III-b, IV-a, IV-b;
- f- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Gjeodezi (Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë).

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijimësi udhëzimet online.

<http://recruit.dap.gov.al/Register.aspx>

***Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës 16 Maj 2015***

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 26 Maj 2015, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë në faqen e internetit të departamentit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga DAP, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**2.4****FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

---

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- a- Të njohë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me, infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- b- Të njohë legjislacionin e BE i cili do jetë pika e referimit në hartimin e akteve nënligjore të ASIG;
- c- Të ketë njohuri për legjislacionin e BE-së që lidhet me gjeoinformacionin (Direktiva Inspire);
- d- Të ketë njohuri sistemeve Reference të pozicionimit GNSS në Shqipëri (ALBPOS);
- e- Të ketë njohuri sistemeve Reference të pozicionimit GNSS Ndërkombëtare.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- f- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- g- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- h- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5****MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## 2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, DAP do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Departamenti i Administratës Publike do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Departamentit të Administratës Publike, për fazat e mëtejshme të kesaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Departamentit të Administratës Publike duke filluar nga data 26 Maj 2015.